



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 02.07.2015, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së Shërbimit Këshillimor Financiar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare”.

2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes kuadër të huasë, ndërmjet Këshillit të Ministrave që përfaqëson Republikën e Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës për projektin e rehabilitimit të spitalit rajonal të Shkodrës, faza e tretë”.

Marrin pjesë: Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Petrit Vasili, Silva Caka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Tom Doshi, Dashamir Peza

Të ftuar:

Milva Ekonomi – zëvendësministre e Shëndetësisë

Andoneta Njehrena - shefe e Sektorit Juridik në Ministrinë e Shëndetësisë

Petro Mersini - drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së Shërbimit Këshillimor Financiar ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare”. Zonja Milva, që është e pranishme këtu, do të flasë shkurt për marrëveshjen.

Milva Ikonomi – Përse na duhet neve kjo marrëveshje, që ka ardhur te ju për t’u miratuar, dhe pse po e bëjmë, sepse mbase ky është kuptimi më i drejtë që unë mund t’i jap, është se ne jemi duke bërë një studim të fizibilitetit për të dhënë me koncesion laboratorët e spitaleve rajonale të qendrave universitare. Ajo që ndodh deri tani është se nuk ka të dhëna të sakta për konsumin që bëjnë laboratorët në Shqipëri, nuk ka një cilësi shumë të mirë të lab testeve, që në një vend, për shembull, në Shkodër, të jenë të unifikuara me ato që nxjerr Vlora, ato që nxjerr Tirana të jenë të unifikuara me ato ata që nxjerr Kukësi, dhe ndërkohë Tirana, QSUT-ja, nuk e mban dot rolin e laboratorit referent. I kanë munguar këto cilësi.

Nga ana tjetër, po të vëmë re sistemin e informacionit që ne grumbullojmë të dhënat për laboratorët, është shumë i vakët dhe ne jemi duke menduar sesi duhet ta bëjmë ne këtë punë.

Në praktikën ndërkombëtare, ato që dalin me palët e treta janë shërbime që kanë të bëjnë me laboratorët, me radiologjinë, me dializën, janë shërbimet mjekësore që janë më të shpeshta që dalin me palet e treta. Ne nuk jemi në gjendje që të marrim plotësisht vendime vetë, por kemi nevojë për t’u konsultuar me ekspertë ndërkombëtare, kryesisht nga ato që vijnë nga W-ECO apo nga OBSH-ja dhe nga organizatat e tjera si, për shembull, Banka Botërore, e cila ka punuar shumë në rajon me këto forma. Ne kemi kërkuar një mbështetje për të na dhënë mundësi teknike për të bërë studimin e fizibilitetit. Për këtë arsye, ne jemi përgatitur, që kur ata të jenë gati, ne t’i ndihmojmë me dy nivele të mëdha diskutimesh. Sërish, kemi një grup pune që duan të dhëna, duan të grumbullojmë ligje, pra t’i krijojmë dosjen dhe nga ana tjetër kemi një grup që janë përdorues të këtij shërbimi, që të mund të bëjmë diskutime për çdo gjë që ata mund të kenë për të diskutuar. Në këtë grup të përdoruesve ne kemi Shoqatën e Laboratorëve Shqiptarë, kemi edhe Fakultetin e Mjekësisë, kemi, gjithashtu, edhe një grup anëtarësh që vijnë nga shoqatat e profesionistëve, për shembull ata që bëjnë më shumë analiza, siç janë të neurologjisë dhe të kardiologjisë. Kjo është puna që do të bëhet për të ratifikuar këtë marrëveshje. Ky është qëllimi, që ne jemi gati për një studim të fizibilitetit. Shuma në këto momente është një shumë simbolike prej 64 mijë dollarësh.

Fatmir Xhafaj – Është një shumë simbolike, por gjithsesi duhet një marrëveshje.

Faleminderit!

Ka pyetje?

Arben Ristani – Çfarë përfaqëson Korporata Financiare?

Milva Ikonomi – IFC-ja, domethënë e kemi përkthyer në shqip, sepse është pjesa e Bankës Botërore, ato që kanë flamurin në njëlloj mënyre globale të studimeve.

Fatmir Xhafaj – Kryesisht merren me konsulencën, asistencën, fizibilitetin dhe të gjitha këto, dhe pasi hyn IFC-ja, ka hyrë Banka Botërore. Është si rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dakord jemi në parim? Dakord.

Jemi dakord me nenin 1, sipas marrëveshjes së bashkëlidhur?

Anila Agalliu – Kemi nevojë vetëm për një shtesë, pas fjalës “ndërkombëtare”...

Fatmir Xhafaj – Neni 2. Jeni dakord? Dakord.

Kush është dakord në tërësi? Dakord.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 02.07.2015, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes kuadër të huasë, ndërmjet Këshillit të Ministrave që përfaqëson Republikën e Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës për projektin e rehabilitimit të spitalit rajonal të Shkodrës, faza e tretë”.

Marrin pjesë: Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Petrit Vasili, Silva Caka, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Tom Doshi, Dashamir Peza

Të ftuar:

Milva Ekonomi – zëvendësministre e Shëndetësisë

Andoneta Njehrena - shefe e Sektorit Juridik në Ministrinë e Shëndetësisë

Petro Mersini - drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Ikonomi, urdhëroni!

Milva Ikonomi – Kjo që biem ne te ju është një gjë që është duke u bërë. Pra, spitali i Shkodrës po rehabilitohet. Në pjesën e rehabilitimit të spitalit të Shkodrës ne menduam të ngrinim një sistem informacioni i cili në të vërtetë nuk ka nevojë të bëhet nga kjo projektkefi që kemi ne. Ndërkohë po ndërtohen dy sisteme informacioni, një që vjen me bashkëpunimin austriak dhe një që vjen me bashkëpunimin e Bankës Botërore, kështu që nuk ia vlen të këto para ne t'i përdornim për këtë qëllim. Një nga shërbimet që ka më shumë nevojë është shërbimi i reanimacionit, i cili ka nevojë të forcohet, të zgjerohet dhe të përmirësohet, sepse kështu ne bëjmë vetëm një kalim nga një zë buxhetor në një tjetër..

Fatmir Xhafaj – Mund të bëhet një rialokim fondesh....

Milva Ikonomi -brenda të njëjtës paketë. Kjo është ideja. Edhe rasti i reanimacionit në Shkodër sepse natyrisht është diskutuar me drejtorinë tone spitalore duke punuar me të gjithë drejtuesit e spitalit të Shkodrës. Është një mendim për të cilin ramë dakord për nevojat.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Dakord. Ka pyetje? Nuk ka.

Jeni dakord në parim? Dakord.

Jeni dakord me nenin 1? Dakord.

Jeni dakord me nenin 2? Dakord.

Jeni dakord në tërësi? Dakord.

E mbyllim mbledhjen.

Faleminderit!

MBLEDHJA MBYLLET